




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (në tekstin e mëtejshëm KGJK), duke u bazuar në nenin 29 paragrafin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr. 03/L-223), si dhe në nenin 526 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 04 nëntor 2015 nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (04/2015)
PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS PËR KOMPENSIMIN E DËMIT PËR PERSONAT E
DËNUAR OSE TË ARRESTUAR PA ARSYE

KAPITULLI I
FORMIMI, KOMPENSIMI DHE MËNYRA E ANGAZHIMIT TË KOMISIONIT

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi është formimi i komisionit, përcaktim i kriterëve të përgjithshme dhe zbatimi i procedurës për kompensimin e dëmit personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye.

Neni 2
Formimi dhe përbërja e Komisionit

- 2.1. Anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre i zgjedh KGJK nga radhët e gjykatave të të gjitha niveleve me mandat tre (3) vjeçar.
- 2.2. Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe dy (2) anëtarë. Në mungesë të ndonjë anëtari, zëvendësohet nga radhët e anëtarëve rezervë. 2.3. Komisionin e mbështet Sekretari i Komisionit i cili caktohet nga drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 3
Kompensimi i Komisionit

Anëtarët e komisionit kompensohen për çdo seancë sipas *Udhëzimit Administrativ për kompensimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe anëtarëve dhe zyrtarëve tjerë në Komisione.*

Neni 4
Mënyra e angazhimit të Komisionit

Seancat e komisionit mbahen pas orarit të rregullt të punës ose ditëve jo të punës.

Neni 5
Udhëheqja e seancave

- 5.1. Seancat e komisionit i udhëheq kryetari i tij.
- 5.2. Në mungesë të kryetarit seanca mund të udhëhiqet nga ndonjë anëtar i Komisionit pas autorizimit paraprak nga kryetari.

Neni 6
Numri i seancave brenda muajit

- 6.1. Komisioni është i detyruar që për çdo seancë pune të shqyrtojë dhe vendos së paku tri (3) lëndë.
- 6.2. Numri i seancave mujore nuk është i kufizuar dhe ato mbahen varësisht nga numri i lëndëve që presin për tu zgjidhur sipas radhës së pranimiit.

KAPITULLI II
PROCEDURA E PARAQITJES SE KËRKESËS DHE KRITERET E PËRGJITHSHME PËR
KOMPENZIMIN E DËMIT PERSONAVE TË DËNUAR OSE TË ARRESTUAR PA ARSYE

Neni 7
E drejta në kompensim

E drejta në kompensim dëmi u takon personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye dhe personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye nga baza e masës së sigurimit - arrestit shtëpiak në kuptim të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Neni 8
Paraqitja e kërkesës për kompensim të dëmit

- 8.1. Personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye, paraqesin kërkesën për kompensim dëmi në dy (2) kopje duke i bashkëngjitur vendime gjyqësore të formës së prerë.
- 8.2. Zyra e pranimiit e Sekretariatit të KGJK-së pas pranimiit të kërkesës për kompensim e evidenton atë me datë të pranimiit dhe me numër rendor dhe ia dorëzon Sekretarit të Komisionit.

Neni 9
Përgatitja e materialit për seancë

- 9.1. Në rast të paqartësive në dokumentacion, Komisioni mund të kërkojë nga gjykata ku është zhvilluar procedura penale shkresat e lëndës të parashtruesit të kërkesës për kompensim dëmi.
- 9.2. Pas pranimit të dokumentacionit të nevojshëm, sekretari i Komisionit në bashkëpunim me kryetarin ose njërin anëtar të Komisionit bën përgatitjen e materialit për seancë të Komisionit.
- 9.3. Kur materiali të jetë gati, sekretari i Komisionit në bashkëpunim me kryetarin dhe anëtarët e tjerë e caktojnë datën e mbajtjes së seancës së Komisionit.
- 9.4. Komisioni, më së voni tre (3) ditë para mbajtjes së seancës njofton parashtruesin e kërkesës ose përfaqësuesin e tij të autorizuar nëse ka, për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës.

Neni 10
Kompensimi për dëmin material/fitimin e humbur

- 10.1. Për dëmin material/fitimin e humbur për personat të dënuar ose të arrestuar pa arsye ligjore, nëse personat janë të papunësuar, shuma e përcaktuar e kompensimit që paguhet është nëntë (9) euro në ditë.
- 10.2. Shuma e njëjtë nga paragrafi 10.1 u pranohet edhe personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye nga baza e arrestit shtëpiak.
- 10.3. Nëse personi përmes kontratës origjinale të punës, dëshmon lartësinë e pagës, i njëjti kompensohet deri në lartësinë e shumës bruto të pagës.
- 10.4. Kompensimi gjithashtu përfshin shpenzimet e mbrojtjes sipas tarifës së Odës së Avokatëve, duke i dëshmuar përmes procesverbaleve të seancave të zhvilluara dhe faturave të paguara përmes xhírollogarisë.
- 10.5. Personat (shtetasit kosovarë) me punë të përkohshme jashtë vendit, si dhe shtetasit e huaj të dënuar ose të arrestuar pa arsye janë të obliguar që gjithë dokumentacionin ta parashtrojnë të vërtetuar në shërbimin e noterisë.

Neni 11
Kompensimi për pako dhe vizita familjare

Në emër të kompensimit për shpenzimet e anëtarëve të familjes për vizitat e bëra personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye, dërgimit të pakove dhe të transportit për anëtarët e familjes, kompensohen me shumën prej njëzet e pesë (25) eurosh për një vizite, përkatësisht me shumën maksimale prej pesëdhjetë (50) eurosh, për dy (2) vizita mujore.

Neni 12
Kompensimi për dëmin jo-material/moral

- 12.1. Për dëmin jo material/moral në emër të dhimbjeve të përjetuara psikike/shpirtërore, frikës dhe turpfit, personi i dënuar ose arrestuar sipas bazës së paraburgimit / dënimit, kompensohet në shumën prej gjashtë (6) euro në ditë.
- 12.2. Për dëmin jo material/moral në emër të dhimbjeve të përjetuara psikike/shpirtërore, frikës dhe turpfit, personi i dënuar ose arrestuar sipas bazës së arrestit shtëpiak, kompensohet në shumën prej gjashtë (6) euro në ditë.

Neni 13
Kompensimi për përpilimin e kërkesës

- 13.1. Për kërkesën e përpiluar nga avokati dhe pjesëmarrjen e tij në seanca (të provuar me vulën e avokatit, në memorandumin e kërkesës), pala kompensohet me shumën sipas tarifës së Odës së Avokatëve në xhirollogari të tij, ose me pëlqimin e vet ekskluziv dhe me shkrim të palës, në xhirollogarinë e përfaqësuesit ligjor.
- 13.2. Për kërkesat e hartuara nga organizatat humanitare, personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye nuk u takon e drejta e kompensimit sipas paragrafit 13.1.
- 13.3. Nëse pala gjatë procedurës për kompensim dëmi pajtohet me shumën e ofruar të dhënë nga Komisioni, atëherë lidhet ujdia jashtëgjyqësore, e cila shërben si titull ekzekutiv për realizimin e pagesës, përkatësisht derdhjen e shumës së parave në xhirollogarinë bankare të palës.
- 13.4. Nëse pala nuk pajtohet me shumën e ofruar nga ana e komisionit, ajo duhet të nënshkruajë këtë mospëlqim dhe më këtë e fiton të drejtën që në procedurën e rregullt gjyqësore, me padi civile të kërkojë kompensimin e dëmit, për të cilën pala pretendon se i takon.

Neni 14
Ekzekutimi i pagesave

- 14.1. Sekretari i Komisionit dhe një zyrtar i Njësitit për Buxhet dhe Financa të SKGJK-së e bëjnë kontrollimin e lartësisë së shumës së përcaktuar për kompensim sipas vendimit të komisionit.
- 14.2. Njësitit për Buxhet dhe Financa pranë Sekretariatit të KGJK-së, është i detyruar, që likuidimin e shumave përkatëse kompensuese të palëve dhe kompensimin për anëtarët e komisionit ta bëjë më së largu 30 ditë nga dita e dorëzimit të dokumentacionit për pagesë.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi 30 ditë pas miratimit .

Prishtinë, me 10/11/2015

Enver Peci
Kryesuesi (KG)

